

BASHKIA TIRANË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “D&E” SH.P.K dhe “ VICTORIA –AL” SH.P.K

Adresa: Tiranë, Yzberisht, Rruga “At Zef Pëllumbi”, pallati Nr. 16 “Dejvi 2001”, me Nr. pasurie 39/118-N10, Zona kadastrale 2679 Vol 31, Mezës & Tiranë, Kashar, Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit.

NIPT: K71804001C & K81531041T

- **OE/BOE me nënkontraktor**

PO ☐ JO ☒

- **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐ JO ☒

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i Procedurës / referenca: **REF- 72416-12-16-2025**

Objekti i kontratës: **“Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH”, Loti I – Blerje Uniforma veshje speciale- Uniformë zjarrrdurese**

Fondi limit: **27,880,050** (njëzet e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024 miratuar VKB Nr. 131, datë 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025” i ndryshuar.

Kohëzgjatja e kontratës: 2 (dy) muaj.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 17.12.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: *Buletini Nr. 82 datë 22 Dhjetor 2025*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi Operatorëve Ekonomik “D&E” SH.P.K dhe “ VICTORIA –AL” SH.P.K

NIPT: K71804001C & K81531041T

Vlera: 20,850,000 (njëzet milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” SH.P.K

NIPT: L52317046G

Vlera: 20,913,000 (njëzet milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Operatori Ekonomik “GENTIAN SADIKU” P.F & “UNIVERS PROMOTIONS” SH.P.K

NIPT: L42314005A & K81324039M

Vlera 23,670,000 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Operatori Ekonomik “EXTRABIS” SH.P.K

NIPT: L22218008Q

Vlera: 23,775,000 (njëzet e tre milion shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Operatori Ekonomik “MALBERTEX” SH.P.K

NIPT: K71821009N

Vlera: 26,250,000 (njëzet e gjashtë milion dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

6. Operatori Ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F

NIPT: M32330045Q

Vlera: 27,750,000 (njëzet e shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm:

1. Operatoreve ekonomik “GENTIAN SADIKU” P.F & “UNIVERS PROMOTIONS” SH.P.K

NIPT: L42314005A & K81324039M

Bashkimi i operatoreve ekonomik “GENTIAN SADIKU” P.F & “UNIVERS PROMOTIONS” SH.P.K nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5, ku përcaktohet se: *“OE pjesëmarrës duhet të paraqesë certifikate konformiteti të rregullores EU 2016 425 ose e përditësuar, për uniformat zjarrëduruese (xhakëtë + pantallona + dorashka + helmet + çizme zjarrëfikëse + kapuc) sipas standarteve të mbrojtjes dhe sigurisë ndaj zjarrit të përcaktuara në specifikimet teknike të DST. Si edhe certifikatën e modulit D sipas rregullores EU 2016/425 lëshuar në emër të prodhuesit për produktet e tekstilit të kategorisë III. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se bashkimi i operatoreve ekonomik “GENTIAN SADIKU” P.F & “UNIVERS PROMOTIONS” SH.P.K nuk disponon certifikatën e konformitetit të rregullores EU 2016/425 ose e përditësuar, për uniformat zjarrëduruese (xhakëtë + pantallona + dorashka + helmet + çizme zjarrëfikëse + kapuc) sipas standarteve të mbrojtjes dhe sigurisë ndaj zjarrit të përcaktuara në specifikimet teknike të DST, si dhe certifikatën e modulit D sipas rregullores EU 2016/425 lëshuar në emër të prodhuesit për produktet e tekstilit të kategorisë III., cka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit.*

2. Operatori ekonomik “EXTRABIS” SH.P.K

NIPT: L22218008Q

Operatori ekonomik “EXTRABIS” SH.P.K nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit të parë, që prokurohet”.* Për përmbushjen e punës së ngjashme, operatori ekonomik “EXTRABIS” SH.P.K ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit kontratat si më poshtë:

1. “Blerje uniforma zjarrfikëse për sektorin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit” me vlerë 7,500,000.02 (shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
2. Faturë tregtare me Nr. 276/2025 me vlerë 92 880,00 EURO pa TVSH.

Nga verifikimi i kontratave të paraqitura në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik EXTRABIS” SH.P.K nuk plotëson vlerën e kërkuar në dokumentet standarte të tenderit, pika 2.3.1, pika 1/a dhe 1/b.

Mangësitë e sipërcituara u konfirmuan nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Mbështetur në Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2 “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....”

3. Operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F

NIPT: M32330045Q

Operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F nuk përmbush Kërkesat e Përgjithshme e të Vecanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

1. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit;
2. Sigurimin e Ofertës ;
4. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024,
5. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023 dhe 2024 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore,
6. Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujesëelles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë.

Operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit të parë, që prokurohet”. Për përmbushjen e punës së ngjashme, operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit kontratat si më poshtë:

1. Faturë tregtare me Nr. 6/2025 me vlerë 397 000,00 ALL (treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.
2. Faturë tregtare me Nr. 17/2025 me vlerë 439 500,00 ALL (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind) pa TVSH

Nga verifikimi i kontratave të paraqitura në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F nuk plotëson vlerën e kërkuar në dokumentet standarte të tenderit, pika 2.3.1, pika 1/a dhe 1/b.

Operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, ku përcaktohet “Operatori ekonomik se duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara” Nga verifikimi i dokumentave të paraqitura në sistemin e prokurimeve elektronike, Operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F , nuk ka paraqitur certifikatën ISO 14001:2015, ose e përditësuar lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit.

Operatori ekonomik “IBERLINA HADJA” P.F nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, ku përcaktohet: “Operatorët ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi....Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurave”

Nga verifikimi i mostrave të sjella nga operatorët ekonomikë rezultoi se “IBERLINA HADJA” P.F nuk ka dorëzuar mostrat pranë autoritet kontraktor, duke sjellë skualifikimin e saj për vazhdimin e procedurave.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve ekonomik **“D&E” SH.P.K dhe “ VICTORIA –AL” SH.P.K** me *NIPT: K71804001C & K81531041T* dhe adresë Tiranë, Yzberisht, Rruga “At Zef Pëllumbi”, pallati Nr. 16 “ Dejvi 2001”, me Nr. pasurie 39/118-N10, Zona kadastrale 2679 Vol 31, Mezës & Tiranë, Kashar, Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej : 20,850,000 (njëzet milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.